



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 45
Prishtinë, më 2.5.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani- Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi- Dragusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku- Kastrati dhe Sergjan Mitroviç.

Pjesëmarrës nga Ministria e Punëve të Jashtme: Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme, Fitim Sadiku, sekretar i përgjithshëm, Florent Muçaj, konsulent i jashtëm, Jetlir Zyberaj, shef i kabinetit, Muhamet Brajshori, MPJ dhe Liridon Llapashtica, këshilltar.

Pjesëmarrës të tjerë: Agonis Thaqi dhe Vjeshtore Zeqiri, D+; Butrint Berisha, PIPS; Yllka Alimusaj, Eugen Cakolli dhe Blerta Aliu, KDI; Marigona Berisha, GP LDK; Ylli Sokoli dhe Hëna Rexhaj, praktikantë; Vlera Rexha dhe Donika Bunjaku, studentë, UP; Egnesa Vitia, Kuvend dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 25 shkurt, 6 e 7 mars dhe 5 e 12 prill 2019;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli;
4. Të ndryshme.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli

Vjosa Osmani Sadriu, tha se ministri është ftuar që të raportojë për aktivitetet në fushën e politikës së jashtme. Ajo njoftoi se raportimi i fundit i ministrit ka qenë në dhjetor, ku janë trajtuar një sërë çështjesh, mirëpo në ndërkohë ka pasur zhvillime të reja në fushën e politikës së jashtme, për të cilat do ta njoftojë komisionin në detaje.

Behgjet Pacolli, sa i përket marrëdhënieve dypalëshe, njoftoi se ka vazhduar të punojë me vendet jashtë Evropës, për të forcuar pozicionin dhe partneritetin e Kosovës me Afrikën, Azinë, Amerikën Latine dhe rajone të tjera. Njoftoi për takimin e Koalicionit Kundër Terrorizmit, të mbajtur në Uashington, ku është takuar me shumë homologë nga e gjithë bota dhe përpos takimit me Sekretarin e Shtetit, ka

zhvilluar kontakte me rëndësi me homologë nga Amerika e Jugut, Afrika, Azia e Evropa. Gjatë këtij takimi tha se është takuar edhe me homologun e tij nga Kolumbia, i cili i ka dhënë notën verbale se ata janë të gatshëm të dekretojnë ambasadorin e tyre jorezident në Kosovë, kurse ne kemi kërkuar miratimin nga ata për hapjen e ambasadës në Kolumbi. Më tej, ai tha se kemi një koncentrim të madh rreth Kilit, për shkak të Asamblesë së Interpolit. Sa i përket Interpolit, kërkoi që të mbahet një mbledhje e rezervuar dhe pa prezencën e mediave, për arsye se informatat janë sekrete dhe të limituara.

Vjosa Osmani- Sadriu, konstatoi se komisioni është i gatshëm që lidhur me raportimin e ministrit për Interpolin, të mbahet një mbledhje me dyer të mbyllura.

Behgjet Pacolli, në vazhdim njoftoi se ka marrë pjesë në Konferencën e Organizatës Islamike në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku është takuar me përfaqësuesit e shteteve të Ukrainës, Indisë, Emirateve të Bashkuara Arabe, Kuvajtit, Arabisë Saudite, Jordanisë, Malajzisë, Maldiveve, Xhibutit, Somalisë, Ugandës, Togos, Gabonit, Omanit, Gambisë, Siera Leones, Afganistanit dhe Bangladeshit. Gjatë këtyre takimeve tha se është biseduar për forcimin e pozitës së Kosovës në këto shtete, për letrën e Serbisë, e cila shpërndahet çdo muaj te këto shtete për mosnjohjen e Kosovës. Lidhur me këtë, tha se përpos këmbimeve të letrave, në takime është potencuar se nuk kemi asgjë të diskutojmë me Serbinë, sa i përket statusit të Kosovës, me të bisedojmë vetëm për përmirësimin e marrëdhënieve të qytetarëve tanë. Më tej, ai njoftoi se ka zhvilluar vizita në Afrikë, në shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, ku është potencuar se duhet të ndodhë njohja e Kosovës nga këto shtete. Bëri të ditur se kryetari i Kuvendit të Etiopisë, si dhe kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Etiopisë, e kanë vizituar Kosovën, me të cilët janë zhvilluar diskutime shumë konstruktive. Zëvendës-presidenti i Kenias ka vizituar Kosovën, duke pasur mundësi t'i tregojnë për Kosovën dhe për realitetin e krijuar këtu. Pacolli njoftoi se ka marrë pjesë në inaugurimin e presidentit të ri të Senegalit, ku është takuar me shumë përfaqësues të shteteve, si: Guinea Bissau, Burkina Faso, Togo, Sierra Leone, Madagaskar, Nigeria, Sao Tome dhe Principe, Republika Demokratike e Kongos, Gaboni, Gambia. Sa i përket lajmeve se shtetet si Guinea Bissau, Madagaskar, Sao Tome dhe Principe dhe Gambia e kanë tërhequr njohjen, tha se ato janë të pavërteta, pasi që ka marrëdhënie shumë të mira me këto shtete. Pacolli bëri të ditur se janë duke punuar në mënyrë intensive që Republika Demokratike e Kongos, ta njohë Republikën e Kosovës, dhe se në takim me presidentin e Etiopisë, ka marrë dëshmi se ky shtet është në proces të finalizimit të njohjes së Kosovës. Ai, po ashtu, njoftoi se kanë ftuar 10 studentë nga këto shtete, të cilët do të marrin pjesë në kurset verore në Universitetin e Prishtinës. Gjatë takimeve me homologun e tij të Japonisë, ministri njoftoi se kanë ardhur në përfundim që Japonia të hapë ambasadën në Kosovë nga janari i vitit të ardhshëm. Ministri, më tej, bëri të ditur se Kosova është aktive në Koalicionin Global kundër ISIS, si kontribuues i përhershëm dhe se kanë punuar në riatdhesimin e qytetarëve që ishin në luftërat në Siri. Sa i përket Kartës së Adriatikut, tha se Kosova e ka statusin e vëzhguesit dhe tendenca është që ta ketë statusin e anëtarit të përhershëm. Sa i përket OSBE-së, njoftoi se kanë komunikim të përhershëm dhe situata në këtë organizatë është shumë delikate. Ministri, gjatë raportimit, bëri të ditur se është hapur Zyra e Kosovës në Athinë, se MPJ është në finalizimin e punëve për hapjen e Zyrës së Kosovës në Sllovaki dhe është iniciuar edhe hapja e një zyre në Bukuresht. Sa i përket marrëdhënieve rajonale, tha se Kosova do ta kryesojë Organizatën për Kooperim të Evropës Juglindore (SEECP), se kanë marrëdhënie shumë të mira me Greqinë, kurse sa i përket bashkëpunimit me Shqipërinë, tha se është verifikuar se 57 marrëveshje janë në procedim e sipër, një marrëveshje është kryer dhe 16 marrëveshje tjera janë duhet të fillojnë.

Vjosa Osmani- Sadriu, lidhur me Samitin e Berlinit dhe për mungesën e qëndrimit uniform të institucioneve të Kosovës, pyeti: A i ka dëmtuar mosuniteti i qëndrimeve të presidentit dhe kryeministrit, raportet bilaterale me dy shtetet nikoqire dhe në përgjithësi raportet e Kosovës në nivel rajonal dhe ndërkombëtar? Sa i përket njohjeve, pyeti: Cila është arsyeja themelore e ngecjes së njohjeve, a është mospuna e institucioneve apo keqpërdorimi i dialogut nga ana e Serbisë?

Elmi Reçica, tha se ministri gjatë punës së tij i ka prekur të gjitha çështjet që janë me interes, jo vetëm të MPJ-së, por edhe të Kosovës. Ai shtoi se ministria ka zhvilluar aktivitete për t'i parandaluar tërheqjet

e njohjeve për të cilat Serbia ka punuar shumë, por se nuk kanë mbetur anash angazhimet, sa i përket diplomacisë ekonomike. Sa i përket integriteteve evropiane, tha se Kosova i ka përmbyllur proceset për liberalizimin e vizave dhe kjo çështje nuk i përket më diplomacisë evropiane, por është çështje e brendshme e shteteve. Lidhur me nismat rajonale, tha se do të duhej që të angazhoheni më shumë dhe t'i përkushtoheni më shumë të gjitha organizmave rajonalë. Reçica, sa i përket Samitit të Berlinit, tha se Kosova është trajtuar barabartë me të gjitha shtetet dhe nuk ka pasur asnjë hezitim, sa i përket pavarësisë së Kosovës dhe tërësisë territoriale.

Zafir Berisha, rreth zhvillimeve në Samitin e Berlinit dhe qëndrimeve jo të koordinuara të institucioneve të Kosovës, pyeti ministrin: A ka marrë diçka që duhet t'i referohet dhe të diskutohet brenda institucioneve që gabimet e bëra në Berlin të mos përsëriten edhe në Paris dhe se çfarë duhet të përmirësojnë institucionet në mes vete, që të dilet me qëndrime që janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës?

Time Kadrijaj, bëri të ditur se Serbia ka hapur zyra ndërlidhëse dhe ka investuar në shumë vende të botës për të lobuar kundër pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimit të saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Lidhur me këtë, pyeti: A është e vërtetë kjo dhe cilat janë veprimet e Kosovës në këtë drejtim? Në takimimin e kryeministrit me ministrin e Punëve të Brendshme të Gjermanisë, tha se është marrë një përgjigje pozitive, sa i përket liberalizimit të vizave. Pyeti: Cilat janë opsionet dhe datat e mundshme që edhe Kosova të mund të lëvizë lirshëm?

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se kabineti i ministrit e ka kontaktuar komisionin, me një propozim konkret rreth mbështetjes së diplomacisë parlamentare dhe jemi pajtuar për një plan vizitash në shtete që mund të kenë ndikim në procesin e liberalizimit të vizave, pastaj në shtete, vota e të cilave na duhet në Interpol dhe njoftoi ministrin që komisioni pajtohet me propozimin e ministrit.

Glauk Konjufca, sa i përket Këshillit të Evropës, njoftoi se para 5 viteve ka qenë me një delegacion të Kosovës në KE dhe gjatë takimeve me përfaqësuesit e KE-së dhe me delegacionet nacionale iu është thënë se Kosova nuk duhet ta ushtrojë aplikimin e vet për KE, pa u themeluar Gjykata Speciale dhe pa e përfunduar punën e saj. Sa i përket kësaj, pyeti: A ka ndryshuar diçka, a janë qëndrimet e njëjta me ato të vitit 2014 dhe 2015, sa i përket Gjykatës Speciale dhe anëtarësimit të Kosovës në KE?

A është emëruar z. Enrique Rais, si konsull nderi i Kosovës në Honduras? Për këtë person në dokumentet e drejtësisë amerikane të botuara, emri i tij del të jetë i lidhur me krimin e organizuar dhe për të ka edhe një urdhër arrest. Më tej, bëri të ditur se drejtësia amerikane i ka botuar edhe e-maillet e tij, në të cilat ndodhet edhe emri i ministrit Pacolli, si bashkëpunëtor i tij. Ai, po ashtu, pyeti: A ka qenë z. Rais pjesë e ekipit të z. Pacolli gjatë takimeve të tij në Honduras? Një tjetër fakt që përmendet për bashkëpunimin e ministri Pacolli me z. Rais, është se z. Pacolli i ka shitur apartament këtij personi në Zvicër dhe pyeti nëse kjo është e vërtetë.

Behgjet Pacolli, bëri të ditur se me z. Rais e ka prezantuar ish-ambasadori i SHBA-ve, z. William Walker, në kohën kur ka lobuar për Kosovën, sa ishte në opozitë dhe i ka sjellë Kosovës mbi 47 njohje të dokumentuara. Ai njoftoi se z. Walker i ka ndihmuar për të shkuar në Salvador, pasi që ka qenë Ambasador i SHBA-së në këtë vend, dhe z. Rais e ka ndihmuar atë deri në arritjen e njohjes nga Hondurasi dhe Salvadori. Pacolli, më tej, informoi se z. Rais posedon një kompani e cila jep me qira avionë, njërin prej të cilëve e ka shfrytëzuar dhe për shfrytëzimin e avionit i ka hapur një letër-kredi kompanisë së z. Rais. Pacolli pohoi se z. Rais e ka blerë një apartament në hotelin e tij, në vlerë prej 2.6 milionë euro, të cilin e ka edhe sot në Lugano.

Vjosa Osmani- Sadriu, pyeti: A është konsull nderi i Republikës së Kosovës?

Behgjet Pacolli, duke iu referuar pyetjes se deputetes Osmani, Pacolli njoftoi se z. Rais nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë konsull nderi i Republikës së Kosovës. Ai tha se e ka propozuar që të dekretohet konsull i nderit, pasi që e ka ndihmuar me dy njohje, por se kjo nuk kishte ndodhur. Pacolli, më tej, tha

se nuk ka pasur asnjë kontakt me z. Rais, për arsye se ai në mes të kohës 2012, 2013 dhe 2014 e ka paguar apartamentin e tij në Lugano.

Glauk Konjufca, për kohën kur z. Pacolli ishte zëvendëskryeministër, në vitin 2011, pyeti: A ka pasur ndonjë lidhje biznesi me z. Rais? Ai, po ashtu, bëri të ditur se në e-maillet që i ka zbuluar drejtësia amerikane, thuhet se z. Pacolli dhe z. Rais kanë filluar së bashku edhe një kompani në Libi.

Behgjet Pacolli, njoftoi se në vitin 2011 nuk ka pasur asnjë lidhje biznesi me z. Rais dhe ai i ka dhënë një kolateral të firmës së tij, për shkak të pagesës së apartamentit. Duke iu referuar deputetit Konjufca, lidhur me bashkëpunimin me z. Rais në Libi, tha se këto janë spekulime dhe nuk ka lidhje me Libinë.

Vjosa Osmani Sadriu, tha se ka pasur edhe emra të tjerë që përfliken që janë konsuj nderi, e ne nuk e dimë se a janë. Në mënyrë që kjo çështje të qartësohet, kërkoi nga ministri që komisionit t'i dërgohet lista e të gjithë konsujve të nderit.

Fitore Pacolli- Dalipi, sa i përket konsujve të nderit, bëri të ditur për skandalin me konsullin e nderit në Benin dhe ministri asnjëherë nuk ka treguar se si e ka propozuar z. Oliver Nutsugan, konsull të nderit në Benin. Ajo pyeti: Pse duhet të kemi një konsull nderi në Benin, çfarë bën ajo konsullatë për Kosovën?

Behgjet Pacolli, sa i përket Samitit të Berlinit, bëri të ditur se delegacioni i Kosovës ka pasur takime të veçanta me ambasadorin amerikan në Berlin, nga i cili kanë marrë mbështetjen e SHBA-së. Para fillimit të takimit me organizatorët, njoftoi se ai dhe kanë pasur një takim me komisionaren Mogherini, e cila paraqet kërkesën që sa më parë të rifillojë dialogu dhe nënvizon se asnjëherë nuk ka biseduar me askënd për ndërrim terriroresh, kufijsh ose për prekjen e kufijve në Kosovë. Pastaj tha se është mbajtur një koktej me kancelaren Merkel dhe presidentin Macron, ku kanë qenë prezentë edhe përfaqësuesit e shteteve të Ballkanit, kurse nga delegacioni kosovar, prezentë kanë qenë presidenti i Kosovës, shefi i zyrës së presidentit, kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme. Pacolli, më tej, njoftoi se takimi është hapur nga znj. Merkel, ka vazhduar fjalimi i presidentit Macron dhe i znj. Mogherini dhe se si rezultat i tri fjalimeve vihet në konkluzion se qëllimi i konferencës është integrimi i shteteve të Evropës Perëndimore, traktati i paqes në mes Serbisë dhe Kosovës, gjegjësisht fillimi i dialogut dhe problemi i funksionimit të institucioneve të Bosnjës e Hercegovinës. Është filluar me kontributet e shteteve të ndryshme, duke filluar prej Shqipërisë, sipas alfabetit e më tutje. Fjalimi i presidentit të Kosovës, ka qenë shumë konstruktiv, por shumë kritik ndaj BE-së, sidomos ndaj atyre që nuk e kanë mbajtur fjalën, sa i përket vizave. Ai ka rikonfirmuar se vënia e taksës ka qenë e drejtë dhe taksa do të qëndrojë, derisa Serbia të japë shenja se ulet në tavolinë. Ka pasuar fjalimi i kryeministrit, po ashtu, me të njëjtin ton, duke përsëritur për mundësinë e dhënë, që procesi i paqes të vazhdojë diku tjetër d.m.th. në Berlin e jo në Bruksel, njoftoi Pacolli. Pas këtij rundi, tha se është mbajtur një pauzë, ku ka filluar presioni te z. Haradinaj, që ai ta bëjë të mundur që të tërhiqet taksa dhe të vazhdojë dialogu. Ai tha se nuk ka dëgjuar se i është bërë ndonjë presion kryeministrit nga ana e presidentit, për heqjen e taksës. Taksa nuk hiqet, derisa mos të ketë qartësi se dialogu do të shkojë në rrugë të drejtë. Ministri njoftoi edhe për takimet e tij dhe angazhimet që ka pasur. Po ashtu, më tej theksoi se deri te Samiti i Parisit do të kemi një definim të qartë të Gjermanisë, lidhur me liberalizimin e vizave. Sa i përket njohjeve, tha se ky proces është ndërlikuar mjaft, sepse bota është ndarë në interesa gjeostrategjike. Bëri të ditur se e kanë identifikuar personin, i cili punon për MPJ-në e Serbisë, kundër Kosovës dhe mënyrën sesi ai punon. Ministri njoftoi se gjatë këtij viti ka pasur 3 vizita në Afrikë dhe ka vizituar shumë shtete, nga shumica e të cilave nuk e kemi njohjen, por e kemi mbështetjen absolute për integritet evropiane të vendit tonë. Ai, më tej, njoftoi edhe për punën që janë duke e bërë me disa shtete, për të arritur deri te njohja nga ato, e cila punë tha se shkon ngadalë. Po ashtu njoftoi se, së shpejti, presin njohjen nga shteti i Kongos.

Vjosa Osmani- Sadriu, pyeti ministrin: A pajtohet se një prej shkaqeve që ka ngecur procesi i njohjeve, është shkak se Serbia keqpërdor dialogun, duke thënë se është dialog për statusin e Kosovës?

Behgjet Pacolli, tha se Serbia e përdor dialogun si dialog për statusin e Kosovës. Ai shtoi se tani bota është ndarë në shtete pro kineze, pro ruse dhe pro perëndimore dhe shtetet që kanë dashur ta njohin Kosovën, ato e kanë njohur dhe tani kanë mbetur shtetet e mëdha. Ministri, më pas, njoftoi se z. Nutsugan është konsull nderi në Benin dhe e ka ndihmuar Kosovën në procesin e njohjeve. Po ashtu, z. Rais ka kontribuar shumë për Kosovën dhe këta kanë qenë vetëm në hetime. Ai tha se Ministria e Punëve të Jashtme ka bërë përgatitjet për aplikim, në Këshillin e Evropës dhe pritet zgjedhja e sekretarit të ri të Këshillit të Evropës për ndërmarrjen e hapave.

Glauk Konjufca, pyeti: Shtetet nacionale, si Gjermania, Franca, a pajtohen që Kosova të aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe a e kanë përmendur Gjykatën Speciale?

Behgjet Pacolli bëri të ditur se ka pasur një takim me shtetet e BE-së, që e kanë njohur Kosovën dhe si konkluzion i këtyre bisedave është se duhet pritur zgjedhjen e sekretarit të ri dhe nuk është përmendur Gjykata Speciale. Ministri deklaroi se gjatë samitit, pala kosovare ka qenë unanime. Ai njoftoi se është marrë akordi nga Suedia për ambasadorin tonë në Suedi, e po ashtu edhe për ambasadorin në Australi, ndërsa janë në pritje të akordit nga Bangkoku. Ministri më tej njoftoi se në shtator do të hapin ambasadën tonë në Katar, si dhe për misionin të përbashkët me Shqipërinë, të cilat pritet të hapen edhe në Hamburg e Danimarkë.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, pyeti ministrin çka pritet të ndodhë pas Samitit të Berlinit me liberalizimin e vizave?

Behgjet Pacolli, tha se Gjermania është vendi kyç për liberalizimin e vizave dhe vizita në MPB, në Berlin, na bënë optimist se Gjermania do të jetë në anën tonë e po ashtu edhe Franca ka filluar të mendojë ndryshe.

Fitore Pacolli- Dalipi, lidhur me njoftimet e ministrit mbi njohjet, tha se ministri me këto informata na lë përshtypjen se njohjet për vendin tonë kanë arritur nga biznesmenët e jo nga shtetet dhe këta persona që ministri i quan të dinjitetshëm, është duke i ndjekur Interpoli. Ajo pyeti ministrin: Cili ka qenë roli i tij në samit, sa zyrtarë kanë marrë pjesë nga MPJ, kush i paguan shpenzimet e derivateve, me rastin e vizitave me aeroplanin e tij privat, ku është interesi për këto shpenzime dhe se pse fokusohet për lobim të shtetet afrikane, e jo të 5 vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën?

Behgjet Pacolli, theksoi se më parë e njoftoi komisionin për takimet që ka pasur me vendet e BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën, për Greqinë, Rumaninë, Sllovakinë. Ai, po ashtu, njoftoi se është duke u punuar edhe me Spanjën dhe është tendencioze të thuhet që po hezitohet të punohet me shtetet evropiane. Sa i përket shpenzimeve të derivateve me rastin e udhëtimeve, tha se mund të informoheni në institucionet shtetërore. Interesi i tij që të punojë, tha se është për shkak se e do Kosovën dhe është krenar për kontributin e tij, që e ka dhënë për të. Për të gjitha njohjet, buxheti i Kosovës nuk ka paguar asnjë cent, ndërsa për Samitin e Berlinit njoftoi se nga MPJ, kanë marrë pjesë dy persona.

Vjosa Osmani- Sadriu, kërkoi të informohet nga ministri, se cila do të jetë natyra e zyrave që pritet të hapen në Greqi, Sllovaki e Rumania. A janë të natyrës ekonomike apo të nivelit më të lartë, atyre ndërlydhëse?

Behgjet Pacolli, tha se nga vetë fakti se zyra në Athinë do të hapet nga MPJ, ajo do të quhet zyrë e misionit të posaçëm të Kosovës.

Vjosa Osmani- Sadriu, pyeti ministrin: A është e nevojshme që zyrtarët të shërbejnë më shumë se 4 vite në një mision, në vend se të ketë rotacion të tyre pasi që ka diplomatë brenda ministrisë?

Behgjet Pacolli, lidhur me diplomatët, tha se është një problem që kërkon kohë për t'u zgjidhur dhe tani janë në shqyrtim të 20 kthimeve dhe 15 shkuarjeve, për herë të parë, në misionin. Më tej, theksoi se gradimet në misionin janë bërë si rrjedhojë e punës së komisionit në MPJ, ku ka pasur në disa raste

edhe lëshime, por se do të tentojë që ato të përmirësohen dhe deri në fund të mandatit të bëhet rotacioni, ashtu siç duhet, për të gjithë.

Vjosa Osmani- Sadriu, kërkoi që nga MPJ t'i përcillet komisionit lista me azhurnimet e fundit të stafit në misione diplomatike. Ajo, po ashtu, pyeti ministrin: A është duke u trajtuar fenomeni i zgjatjes së procedurave nëpër konsullata për bashkatdhetarët tanë, duke pasur parasysh se ka ankesa nga ata?

Behgjet Pacolli, duke u ndërlidhur me çështjen e ngritur nga kryetarja e komisionit, tha se në ministri komisioni dicitlinor i shqyrton këto çështje, por më se 60% e rasteve të ankesave të bashkatdhetarëve janë mungesa e duhur e dokumentacionit të tyre, por mund të ketë edhe ndonjë rast neglizhence nga stafi.

Fitore Pacolli Dalipi, pyeti ministrin: A është ndërmarrë ndonjë hap, lidhur me ankesën e Shoqatës Sindikale të Shërbimit të Jashtëm, në të cilën janë cekur shkeljet, të cilat thuhet se kanë ndodhur në ministri, ndër të tjera gradimi i parregullt i personave që janë emëruar në pozita të ndryshme në shërbimin e jashtëm?

Behgjet Pacolli, njoftoi se në ministri ka punuar komisioni, i cili i ka verifikuar ato gradime të cekura dhe pas verifikimit i ka nënshkruar, shumicën nga ato dhe kanë mbetur edhe disa raste, të cilat janë në verifikim e sipër për gradime të larta.

Fitore Pacolli- Dalipi, kërkoi që komisionit t'i dërgohet një përmbledhje për procesin e gradimit.

Behgjet Pacolli, tha se gradimi është një proces, i cili ka filluar dhe ende nuk ka përfunduar dhe komisionit do t'ia përcjellë një përmbledhje se kush është graduar dhe mënyrën e gradimit të tyre.

Vjosa Osmani- Sadriu, rreth gradimeve në fjalë, tha se përmbledhja duhet të përmbajë edhe bazën ligjore të gradimeve, përvojën e punës dhe kriteret tjera, të cilat kërkohen për gradime. Më tej, shtoi se raporti i fundit i OSBE-së për Kosovën e ka trajtuar Kosovën në mënyrë jo të drejtë, përkundër faktit se e trajtojnë, bazuar në parimin e neutralitetit të statusit të saj. Pyeti ministrin: A pajtohet me këtë konstatim dhe a kanë reaguar si ministri, lidhur me këtë raport? Ajo propozoi që për raportin e radhës të ndërmerret diç, së bashku me shtetet mike anëtare të OSBE-së, në mënyrë që të mos lejohen, në të ardhmen, hapa të tillë për Kosovën.

Behgjet Pacolli, lidhur me raportin e fundit të OSBE-së, tha se janë duke përgatitur një ankesë, e cila do t'i parashtrahet edhe kryesuesit të OSBE-së. Ai theksoi se nëse komisioni ka ndonjë artikullim, atë mund ta shprehë.

Vjosa Osmani- Sadriu, sa i përket ankesës për raportin e OSBE-së, propozoi që t'i përcillet komisionit, në mënyrë që komisioni t'i dërgojë komentet shtesë. Ajo kërkoi që komisionit t'i dërgohet dokumentacioni, lidhur me akreditimet në Athinë, Sllovaki dhe Rumani, duke theksuar edhe kërkesat për material për konsuj nderi, listat e azhurnuara për dekretimet më të reja dhe informatat për gradimet e fundit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.